



AVOKATI I POPULLIT



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, 2023

NJOFTIM

**PËR
ZGJATJEN E AFATIT PËR SHPALLJEN
E NJË VENDI VAKANT PËR
KOMISIONER NË SEKSIONIN PËR ORGANET E ADMINISTRATËS
QENDRORE, TË PUSHTETIT VENDOR DHE TË TË TRETËVE QË
VEPROJNË PËR LLOGARI TË TYRE NË INSTITUCIONIN E
AVOKATIT TË POPULLIT**

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, për shkak të numrit të kufizuar të kandidatëve që kanë shprehur interes për të konkuruar në pozicionin komisioner, Institucioni i Avokatit të Popullit zgjat afatin e aplikimit për shpalljen e konkurimit për 1 (një) vend vakant për Komisioner dhe konkretisht:

✓ *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;*

Sipas nenit 33, pika 1, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet ligjore të mëposhtme:

- Të kenë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë / “Master shkencor” ose tituj të ekuivalentuar me të;
- Të kenë vjetërsi në profesion si jurist jo më pak se 10 vjet;
- Të mos jenë të dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- Të mos jenë anëtarë të partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër.

Po sipas nenit 31, pika 2, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, kandidati që përmbush kushtet e mësipërme ligjore, do të vlerësohet Komisioner edhe në bazë të plotësimit të këtyre kriterëve objektive:

- Vjetërsisë në profesion;
- Ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë dhe gëzimit të titujve shkencorë;
- Njohurive të thelluara dhe/ose kualifikimit në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;
- Veprimtarisë së njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve;
- Të gëzojë integritet të lartë moral dhe figurë të pastër etiko-morale.

Përmbajtja e dokumentacionit

Kandidati duhet të dorëzojë dokumentat si më poshtë në 2 (dy) kopje:

- Shprehje interesi ku të specifikohet për drejtimin e cilit Seksion do të aplikojë;
- Kopje të plotë të jetëshkrimit (CV) ku të përfshihet edhe një numër telefoni, adresa e postës elektronike (e-mail) dhe adresa e saktë e vendbanimit;
- Kopje të dokumentit të identitetit;
- Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) dhe/ose dokumente të tjerë të barazvlefshëm që vërtetojnë eksperiencat profesionale të kandidatit si dhe përmbushjen e kushteve ligjore për aplikim;
- Diplomën e studimeve universitare që provon se ka mbaruar arsimin e lartë juridik, “Master shkencor” ose tituj të ekuivalentuar me të, si dhe çdo dokument tjetër që provon ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë, thellimin e njohurive, marrjen e titujve shkencorë apo kualifikimit në fushën e të drejtave të njeriut dhe ligjit, ose veprimtarinë e njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve, të noterizuara;
- Dokument që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (anglisht dhe/ose frengjisht);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore që vërteton se nuk ka qënë i dënuar penalisht;
- Deklaratë personale për mosqenien anëtar i partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër;

- Formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”¹, të plotësuar dhe nënshkruar në formën e kërkuar;
- Formularin tip të Aplikimit sipas ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”² të plotësuar dhe nënshkruar në formën e kërkuar;
- Deklaratë personale që dokumentat e dorëzuar janë të plotë, të saktë, të vërtetë e gjithpërfshirës.

Gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit, mund të kërkohen dhe dokumenta shtesë në funksion të vërtetueshmërisë të plotësimit të kushteve ligjore të përmendura më sipër.

Rregullat dhe procedurat standarde për përzgjedhjen e kandidatëve

Rregullat dhe procedurat standarte për përzgjedhjen e kandidatëve, përfshirë dhe fazat në të cilat do të kalojë procesi i përzgjedhjes, janë të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Avokati i Popullit me Urdhër Nr. 199 datë 09.12.2021, të cilat janë publike dhe mund të konsultohen në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit³.

Fusha e njohurive

- a) *Për pozicionin Komisioner në Seksionin për organet e Administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Puna e Seksionit

Puna e Seksionit për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre fokusohet kryesisht në respektimin e të

¹ Të cilin e gjeni në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/formular%20vetedeklarimi%20per%20zbatimin%20e%20ligjit%20138%202016.docx>

² Të cilin e gjeni në linkun:

https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Formular_per-zyrtaret-final-PERDITESUAR.pdf

³

Link:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Urdher%20199.%20date%2009122021%20per%20miratimin%20e%20rregullores%20per%20procedurat%20dhe%20kriteret%20per%20perzgjedhjen%20e%20kandidateve%20per%20komisioner%20ne%20institucionin%20e%20Avokatit%20te%20Popullit.pdf>

drejtës së pronës nga organet e adminstratës publike, marrëdhëniet e punës, çështjet e stehimit, mbrojtjen e konsumatorit, ofrimin dhe garantimin e shërbimeve publike në nivel qendror dhe lokal etj. Kandidatët do të vlerësohen duke pasur në konsideratë njohuritë e tyre në lidhje me:

- ✓ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ✓ Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- ✓ Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”;
- ✓ Ligjin nr. 111-2018” Për Kadastrën”;
- ✓ Ligjin nr.20/2020, “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”;
- ✓ Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik”, i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”;
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- ✓ Parimet e Parisit të OKB-së dhe Parimet e Venecias në lidhje me funksionimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut;
- ✓ Rrjetet evropiane dhe ndërkombëtare të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Aplikimi

Aplikimet duhet të dërgohen/depozitohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokatit të Popullit

Blv. “Zhan D’Ark”, nr.2, Tiranë, Shqipëri

Në dosjen e aplikimit, përveç dokumenteve të kërkuara, kandidati duhet të japë adresën e saktë të vendbanimit, një numër telefoni (fiks apo mobile), si dhe një adresë e-mail.

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë **01.02.2023, ora 16:30**. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë, ndërkohë që kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet ligjore, do të njoftohen zyrtarisht për arsyet e skualifikimit.

Për çdo sqarim apo paqartësi në lidhje me këtë proces aplikimi, mund të kontaktoni në numrin e tel: 04 2380345/ 0675210188 ose në adresën e postës elektronike: renisa.tusha@avokatipopullit.gov.al info@avokatipopullit.gov.al .

Njoftimet dhe informacionet e nevojshme lidhur me procedurën dhe fazat e konkurrimit do të publikohen në një seksion të posaçëm të krijuar për këtë qëllim në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, link:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article-ildp-layout/transparency>

Rubrika: “Shpallje për pozicion Komisioner”.

Suksese!